



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 03-111/01-23064
Datë: 13.05.2024

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QKMF-Dr.Mehdi Zejnullahu-Lipjan

Bazuar ne nenin 78,80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Katër (4) Mjek të Përgjithshëm në QKMF-njësia e Urgjencës

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mjek të Përgjithshëm:

1. Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen duke respektuar kodin e mirësjelljes.
2. Bën diagnozën initiale dhe trajtimin e sëmundjes.
3. I përgjigjet nevojave të njësisë së Urgjencës si dhe QKMF-së sipas nevojës
4. Referon tek specialisti, nëse është e domosdoshme.
5. Kryen shërbime të shëndetit riprodiktiv, kujdesit antenatal dhe postnatal.
6. Shërbime shëndetësore për fëmijë.
7. Promovon edukimin shëndetësor në shoqëri.
8. Trajton lëndimet e vogla.
9. Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme.
10. Gjatë punës së tij i asistojnë infermierët.
11. Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i Kujdesit Primar Shëndetësor në njësinë e Urgjencës dhe sipas nevojës edhe në QKMF-ë
12. Për punën e tij/saj i përgjigjet stafit udhëheqës të QKMF-së dhe DSHPS-së.

Kushtet dhe kriteret për Mjek të Përgjithshëm:

- Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.

Paga mujore për Mjek të Përgjithshëm:

Grupi H klasa H10 **Koeficienti:7.4**

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data **13.05/2024** deri me **11.06/2024** që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini

